



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E PEJËS
OPŠTINA PEĆ
MUNICIPALITY OF PEJA



Në bazë të nenin 80 dhe 81 të Ligjit për Zyrtaret Publik Nr.08/L-197, nenit 8 të Ligjit të Punës, nenit 5 pika c të Ligjit për Arsimin në Komunitet në Republikën e Kosovës nr.03/L-068, Ligjit për Arsimin Parauniversitar neni 35, Udhëzimin Administrativ të MASHT-it nr 05/2021 dhe Rregullorës nr 19/2024 për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zevëndësdrejtorëve, Mësimdhënësve, Bashkpuntorëve Profesional, Asistentëve, Instrukturëve dhe Sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore dhe Aftësuese të Arsimit Parauniversitar, Drejtoria e Arsimit në Pejë shpallë:

KONKURS

për plotësimin e vendeve të punës

Institucioni: Komuna e Pejës-Drejtoria e Arsimit

Titulli i vendit të punës: Nëpunës të Shërbimit Publik

1. SHFMU "Dardania" në Pejë 20 orë Matematikë në afat të caktuar (një vend pune).
2. SHFMU "Xhemajl Kada" në Pejë tetë (8) orë TIK dhe katër (4) orë në Shkollën e Mjekësisë mësimi në Gjuhën Boshnjake në afat të caktuar (një vend pune).

Numri i Pozitave: 2

Lloji i Pozitës: Nëpunës i Shërbimit Publik

Titulli i mbikëqyrësit: Drejtorit

Grada-Koeficienti: 6.60

Nr.Referencës: 01-112/01-0021829/26

Data e Njoftimit: 03.04.2026

Data e Aplikimit: Konkursi mbetet i hapur nga data 03.04.2026 deri me 10.04.2026.

Përshkrimi i detyrave të punës:

-Të realizoj planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e./saj/të punës.

-Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.

-Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.

-Të tregojë respekt dhe të sillet me drejtësi, barazi dhe pa dallime me bashkëpunëtorët të cilët punon.

-Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit, të cilit i raporton, dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktojë ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.

-Të mos kërkojë apo të pranojë udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç drejtorit të shkollës dhe DKA-së.

-Të mos e shfrytëzoi pozitën e punës për interesa private në dobi të ndonjë pale të tretë, përfshirë edhe familjen, shoqërinë apo miqësinë e tij.

-Të ushtrojë maturi maksimale lidhur me të gjitha çështjet e punës. Përfshirë, ruajtjen e informatave (nëse nuk janë publike), të cilat lidhën me procesin e punës dhe raporteve të krijuara prej saj, duke mos komunikuar këto informata me asnjë person fizik dhe juridik, përveç kur informatat e tilla janë të parapara në kuadër të detyrave sipas kësaj kontrate apo autorizimit nga zyrtari të cilit i raporton.

-Puna do të monitorohet dhe të vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve, sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

Kriteret e përgjithëshme për pranim në detyrë të zyrtarve publik

- 1.Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- 2.Të ketë zotësi të plotë veprimi sipas legjislacionit në fuqi;
- 3.Të zotëroj të paktën njërën nga gjuhët zyrtare ,në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- 4.Të jetë i aftë për të kryer detyrat përkatëse;
- 5.Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje;
- 6.Të mos ketë në fuqi masë disiplinore;
- 7.Të ketë arsimimin e kërkuar për pozitë në të cilën aplikon;
- 8.Të kaloj me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara me Ligj

Kushtet e kualifikimit dhe kriteret e përzgjedhjes:

Përzgjedhja e kandidateve do të bëhet në bazë të kriterve të përcaktuara me aktet juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar (Ligjit nr 04/L-032 dhe Ligjit nr 03/L-068) dhe në përputhje me Udhëzimin Administrativ të MASHT-it nr 05/2021 për Normativin e Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithëshëm ,Regullores nr 19/2024 si dhe Udhëzimit Administrativ nr 05/2015 Normativit për Mësimdhënësit e Arsimit Profesional.

Për vendet e punës nga 1 deri në 12 kërkohet përgaditje profesionale adekuate sipas lëndëve të shpallura:

-Fakulteti i Edukimit -Master arsimor 300 ECTS

-Sistemi 4 vjeçar

-Bachelor 240 ECTS

Në mungesë të kandidatëve me përgaditje adekuate profesionale në shprehje vijnë kandidatët me përgaditje me të përafert të cilët mund të zgjidhen për një vit shkollor.

Dokumentet e nevojshme:

- Ekstrakti i lindjes (kopje);
- Diploma e noterizuar e fakultetit –(kopje);
- Letërnjoftimi (kopje);
- Certifikatën nga Gjykatëse nuk është nën hetime(origjinali);
- Certifikata të trajnimeve (kopje);
- Vertetimin e përvojës së punës (nëse ka);
- Vërtetimi për zotësin e plotë të veprimit nga QPS (pas pranimit në punë);
- Çertifikaten shëndetësore (pas pranimit në punë)

Vlerësimi i Kandidatëve:

Vlerësimi i njohurive ,aftësive dhe cilësive profesionale të kandidatëve bëhet përmes:

- a)Testi me shkrim ,i cili përbën 50% të vlerësimit të përgjithshëm dhe që ka total 100 pikë;
- b)Intervistës me gojë pjesë e së cilës është edhe vlerësimi i portofolios,përbën 50 % të vlerësimit të përgjithshëm.

Dokumentacioni dorëzohet në kopje, pasi që i njëjti pas përfundimit të procedurave të rekrutimit nuk kthehet.

Të gjithë kandidatët e interesuar, aplikacionet mund ti marrin në formë fizike në Drejtorin Komunale për Arsim në Pejë, apo ti shkarkojnë nga portali shtetëror <https://konkursi.rks-gov.net/> dhe të plotësuara ti dorëzojnë në Drejtorin për Arsim. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret dhe hyjnë në listën e ngushtë do të ftohen në intervistë. Të gjithë kandidatët të cilët kanë mbaruar studimet jashtë Republikës së e që konkurrojnë për këto pozita, duhet që diplomat e tyre (gradat universitare të fituara) të jenë të njohura (nostrifikuara) nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, në pajtim me Udhëzimin Administrativ, nr.12/2018 të datës 10.09.2018, në të kundërtën komisioni gjatë selektimit të aplikacioneve, do të refuzoj çdo aplikacion të kandidatëve të cilët nuk e kanë plotësuar këtë kusht të konkursit. Mirëpriten aplikacionet prej meshkujve dhe femrave të të gjitha komuniteteve të Republikës së Kosovës. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen. Për çdo paqartësi aplikuesit i drejtohen DKA-së, zyra nr. 33 ose në tel 045 108 914. Rezultatet shpallen në web faqen e komunës së Pejës <https://kk.rks-gov.net/pejëi/>dhe në linkun :<https://konkursi.rks-gov.net/>.